



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:287150

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06512063

2024:317190

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve E.F.nga fsh. ..., E.M. nga fsh. dhe A.F. nga Ferizaj, për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nen par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, dhe për të pandehurin E.F.edhe për shkak të veprave penale, Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 dhe veprës penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1686/24 të datës 08.11.2024, ka mbajtur shqyrtimit fillestar publik më datë 12.11.2024, në prani të prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarve A.L. dhe A.L.1 nga Ferizaj, të pandehurve Elion Fejza dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av.Bekim Sylejmani, E.M. dhe mbrojtëses së tij me autorizim av. Elvira Heta Vata dhe A.F. me mbrojtësin te tij sipas detyrës zyrtare av.Arbër Jashari, me datë 14.11.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 18.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

I. Eliot Fejza, nga i ati A., e ëma L., e gjinisë A., i lindur më dt..... ne Ferizaj, me vendbanim në fshatin..... Komuna, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor –receptionit në hotelin, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Kosovës, me nr. personal, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

II. E.M., nga i ati H., e ëma A., e gjinisë K., i lindur më dt. ne, me vendbanim ne fshatin Komuna, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në mobileri, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Kosovës, me nr. personal, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

III. A.F., nga i ati Sh., e ëma E... e gjinisë A..., i lindur më dt. në Ferizaj, ku dhe tani jeton në rrugën ‘.....’, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kamarier, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, profesioni kamerier, shqiptar, shtetas i Kosovës, me nr. personal, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

JANË FAJTOR

I

Për shkak se tre të pandehurit më datë 12.10.2024, rreth orës 23:00 në rrugën ‘.....’ në Ferizaj dashje dhe ne bashkëkryerje duke përdor mjete te rrezikshme- të forta, iu kane shkaktuar lëndime të lehta trupore te dëmtuarve A. L.1 dhe A.L., në atë mënyrë që fillimisht te nisen te dëmtuarit me veture ne drejtim te shtëpisë tyre, ndërsa tre të pandehurit nga mbrapa i ndjekin me veturë dhe të pregaditur me mjete (shufër metalike dhe boks të hekurit), fillimishtë i pandehuri E.F.e hap dritaren duke ju thene se: *hajdeni këndeje pas neve se këtu ka kamera, se rob ka me ju q....., ka me ju mbyt*, posa kane arritur ne shtëpi te dëmtuarit ne atë moment kane arritur edhe te pandehurit dhe para dyerve te oborrit te shtëpisë se të dëmtuarve, fillimisht i pandehuri E.F.një arme te gjatë (kallash) e ka drejtuar ne drejtim te dëmtuarve dhe pastaj dy të pandehurit E.M. dhe A. F. me shufër metalike e kane goditur në kokë, shpinë te gjitha pjesë te trupin te dëmtuarin A.L., pastaj E. F. me një boks të hekurit e ka goditur në pjesën e kokës të dëmtuarin A.L. dhe aty i pandehuri A. F. e godet me shufër metalike në pjesën e kokës të dëmtuarin A. L.1, po ashtu i pandehuri E.M. me një boks të hekurit e godet në të gjitha pjesët e trupit të dëmtuarin A. L.1, pastaj i afrojnë së bashku dy të dëmtuarit dhe i sulmojnë me mjete të forta, pas këtyre goditjeve, i pandehuri E. F. ka hipur në veturë dhe aty ka qenë afër i dëmtuari A.L. i cili vazhdimisht është munduar që ti largojë armën nga dora, por i pandehuri E. e tërheq zvarrë me veturë duke ia zënë dorën me derë të veturës të dëmtuarit A. L. dhe pastaj e duke shkuar nga mbrapa me veturë e përplas për muri të një shtëpie të dëmtuarin, nga shtëpia ka dalë nëna e te dëmtuarve Sh. Luzha, duke dashur qe ti ndaloj por te pandehurit kane vazhduar qe ti godasin te

dëmtuarit në prezencën e nënës së tyre, me ç ‘rast të dëmtuarve iu kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të konstatuara sipas ekspertizës mjeko-ligjore të datës 28.10.2024.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nen par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së.

II

Ndërsa i pandehuri E. F.

Sepse me datën, kohën dhe vendin e cekur si në dispozitivin e parë, me dashje, me mjetë – armë, e me vepra dhe gjeste dhe me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit i ka kanosur seriozisht se do ti privojë nga jeta të dëmtuarit A. L.1 dhe A.L., në atë mënyrë që posa arrin tek shtëpia e të dëmtuarve del nga vetura dhe armën e gjatë AK 47 kallashnikov e ka drejtuar ne drejtim te dëmtuarve dhe njëkohësisht i fyen dhe shanë me fjalë të rënda, me ç raste të dëmtuarëve iu ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe pasiguri.

Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Po ashtu si me datën, kohën dhe vendin e cekur si në dispozitivin e parë, pa autorizim e ka mbajtur në kontroll dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët në Kosovë, në atë mënyrë që armën e gjatë AK 47 kallashnikov e kishte marrë në shtëpinë e të pandehurit E.M. dhe natën kritike armen e tillë e ka drejtuar në drejtim te dëmtuarve A. L.1 dhe A.L., e cila armë është sekuestruar nga policia.

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 17, 21, 38, 39, 44, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 dhe neneve 185, 181 e 366 Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe në bazë të neneve 364, 452, 462, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit të parë i,

Për pikën 1. të dispozitivit, për bashkëkryerje të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nen par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 /dymbëdhjetë / muajve

Për pikën 2. të dispozitivit, për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 /dymbëdhjetë/ muajve.

Për pikën 3. të dispozitivit, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dënim me gjobë në shumë prej 800(tetëqind) Euro.

Gjykata konform, nenit 76 të KPRK-së, të pandehurin e parë e:

GJYKON ME DËNIM UNIK

Me burgim me kusht dhe Gjobë

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 24 /njëzetë katër / muajve dhe me dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) Euro. Dënimi i shqiptuar me burg nuk do të ekzekutohet me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 2 /dy/ viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale (koha verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet.

Ndërsa të pandehurin e dytë dhe të tretë i gjykon:

Të pandehurin e dytë, për pikën 1. të dispozitivit, për bashkëkryerje të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nen par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim me burg konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 800 € / tetëqind euro/.

Të pandehurin e tretë, për pikën 1. të dispozitivit, për bashkëkryerje të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nen par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim me burg konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 800 € / tetëqind euro/.

Dënimet e shqiptuar me gjobë, që të tre të pandehurit obligohen ti paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se të pandehurit nuk i paguajnë dënimet me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par.3 të KPK-së, të njëjtve dënimet do tu shndërrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'iu llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Në dënimin e shqiptuar të pandehurve do tu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 13.10.2024 gjer me dt. 12.11.2024.

Obligohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj secili ve e veç shumën prej nga 30 Euro (tridhjetë euro), ndërsa konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të kimit shumën prej nga 20 /njëzet/ Euro, si dhe obligohen që në mënyrë solidare ti paguajnë edhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko ligjore) në shumë prej 20 €, /njëzet/ Euro, që të tri shumat obligohen ti paguajn mbrenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Të pandehurit të parë, në kuptim të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, i **KONFISKOHET** në mënyrë të përhershme arma e gjatë AK 47 kallashnikov, e cila i është sekuestruar nga policia.

Të dëmtuarit A. G. L. dhe A. G. L. nga Ferizaj, që të dytë nga Ferizaj, rruga “.....”, për realizimin e kërkesave pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën e saj PP/II.nr. 1686/2024, të datës 08.11.2024, ka ngarkuar të pandehurit për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nen par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të pandehurin E.F. edhe për shkak të veprave penale, Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe t'iu shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj Gjykate, pasi veprat penale për të cilat janë proceduar për të pandehurit gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku janë kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimet fillestar publik më datë 12.11.2024, në prani të prokurorit të shtetit, të dëmtuarve, të pandehurve dhe të mbrojtësve të tyre- avokatëve.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, iu ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë e tyre për veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Të pandehurit në shqyrtimin fillestar publik secili veç e veç kanë deklaruar se: e ndiejnë veten fajtor për veprat penale për të cilat i ngarkon aktakuza dhe ate për të gjitha pikat e tyre.

I pandehuri i parë ka deklaruar, e pranoj fajësinë për veprat penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të tyre dhe ate për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par 1 nënpar. 1 .4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare dhe ate pas konsultimit të mjaftueshëm me avokatin tim mbrojtës, ju kërkoj falje publike palës së dëmtuar, jam penduar thellë për veprimet e mia, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin dhe shpresoj që është hera e fundit dhe në fund shtoj se jam i gatshëm që palëve të dëmtuara t,iu kompensoj dëmin që konsideroj që iu kamë shkaktuar në këtë rast.

I pandehuri i dytë ka deklaruar, e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par 1 nënpar. 1 .4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare dhe ate pas

konsultimit me avokatin tim mbrojtës, ndihem penduar shumë dhe u kërkoj falje publike palës së dëmtuar, premtoj se më asnjëherë nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin.

I pandehuri i tretë deklaroi, e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për bashkëkryerje së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par 1 nënpar. 1 .4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare dhe ate pas konsultimit me avokatin tim mbrojtës, ndihem e penduar për veprimet që i kam bërë në rastin konkret dhe u kërkoj falje publike palës së dëmtuar dhe më vie shumë keq për rastin që na ka ndodhur, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe premtoj se në të ardhmen më asnjëherë nuk do të kemi probleme me palën e dëmtuar.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurve deklaron, nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për veprat penale që i ngarkon kjo aktakuzë pasi që një pranim të tillë e benë vullnetarisht nga ana e tyre dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit te tyre dhe duke pasur parasysh faktin se ky pranim mbështet në provat dhe faktet që i përmban kjo aktakuzë, andaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë së të pandehurve dhe me rastin e caktimit dhe llojit të lartësisë së dënimit gjykata të merr parasysh si rrethana rënduese mënyrën e kryerjes së veprave penale, shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprave penale, ndërsa si rrethana lehtësuese të merret pranimi i fajësisë. Sa i përket të pandehurve E.F.dhe E.M. janë persona me të kaluar kriminale për veprë të njëjtë penale dhe janë të gjykuar edhe nga departamenti për të mitur, ashtu siq është përshkruar në aktakuzë, ndërsa i pandehuri A.F. është i dënuar më parë me aktgjykim nr. 2024:193454, i dt. 26.09.2024, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, Po ashtu i propozoj gjykatës që në kuptim të nenit 366 par. 3 të KPRK-së që në mënyrë të përhershme të bëj konfiskimin e armës e cila është e përshkruar në diapozitivin e tretë të aktakuzës .

I dëmtuari A.L. lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurve deklaron se e përkrahi në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe po ashtu paraqes kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari A.L.1 lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurve deklaron se e përkrahi në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe po ashtu paraqes kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit të parë deklaroi se: ne si mbrojtje dakordohemi në pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim duke konstatuar se pranimi mbështet në nenin 242 par. 1. 2 pika 2.1, 2.2, 2.3 . 2.4 e KPRK-së , prandaj ne propozojmë gjykatës që konform nenit 242 par. 6 të aprovoj pranimin e fajsis nga ana e të pandehurit. Gjykata gjatë procesit të vendosjes sa i përket sanksionit penal ndaj të mbrojturit tim të merr në konsiderata edhe disa rrethana lehtësuese dhe ate pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, pendimin e thellë dhe të sinqertë që i njëjti e dha para gjykatës, kërkim faljen , deklarimin e të njëjtit se në çdo kohë dhe moment është në gjendje të bëjë kompensimin real të dëmit që u ka shkaktuar të dëmtuarve , si rrethana lehtësuese gjykata të merr për bazë se i mbrojturi im është i vetmi person që kontribuon në familjen e tij e cila përbëhet prej dy prindërve dhe një motër, gjithashtu edhe sa i përket gjendjes materiale ekonomike është i gjendjes së dobët ekonomike. Gjykata gjithashtu të merr për bazë edhe shkallën shumë të ulët të dashjes sa i përket kësaj veprë penale e cila ka ndodh në mënyrë të atëçastshme dhe se më herët nuk i ka njohur të dëmtuarit ose të kenë pasur ndonjë problem në çfarëdo rrethane. Propozojmë gjykatës që të zbaton dispozitat e nenit 70 par.1 , 3 pika 3.2 , 3,8, 3.9 dhe 3.10, 3.11, 3.12 pastaj nenin 71 , 72 par. 1 pika 1.5 të KPPRK-së, që kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit ashtu siq parashihet në nenet e cituara më lartë.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe duke i studiuar me përpikëri dispozitat ligjore mbrojtja konsideron se në rastin konkret edhe me shqiptimin e një dënimi të kushtëzuar të paraparë në nenin 48 arrihet qëllimi i paraparë i këtij dënimi dhe se është adekuat për rastin konkret, për pos nëse gjykata nuk merr për bazë këtë propozim gjykatës i propozojmë që të pandehurit ti shqipton ndonjë dënim tjetër i cili dënim të zëvendësohet me dënim me gjobë për të cilin ne japim pëlqimin e shndërrimit të dënimit me burg në dënim me gjobë. Sa i përket të kaluarës kriminale të të mbrojturit tim ne njoftojmë gjykatën se i mbrojturi im deri më tani nuk ka asnjë aktgjykim të formës së prerë për të cilin është dënuar dhe që është kërkesë ligjore për tu vërtetuar e kaluar kriminale e të njëjtit, prokuroria përmendi disa vepra por ato janë dy vepra të cilat i ka kryer gjatë kohës sa ka qenë i mitur të cilat ligjërisht nuk hyjnë në domenin e të kaluarës kriminale.

Mbrojtësja e të pandehurit të dytë deklaroi se, e mbështes pranimin e fajësisë sapo të bërë nga i mbrojturi im pranim i cili është në harmoni të plotë me të gjitha shkresat e lëndës dhe i cili është bërë që në fazën e parë të hetimit në stacionin policor , duke shprehur pendim dhe keqardhje të thellë dhe tani këtu para jush duke i shërbyer në radhë të parë sinqeritetit të tij të thellë dhe parimit të ekonomizimit, andaj mbrojtja kërkon nga ju që të pranoni këtë pranim fajësie i cili është në harmoni të plotë me nenin 242 të KPPRK-së dhe të njëjtin ta merrni si

rrethane veçanërisht lehtësuese me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit. Meqenëse jemi në shqyrtim fillestar dhe nuk kemi fjalë përfundimtare më lejoni ti radhis disa pika të cilat do të ju ndihmojnë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit e që konsideroj se do të merren si rrethanë veçanërisht lehtësuese nga gjykata, pranimi i fajësisë i cili është bërë që në fazën e parë dhe ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare duke shprehur pendim të thellë për rastin për të cilin akuzohet, kërkim faljen publike ndaj të dëmtuarve duke shprehur keqardhjen e tij, premtimin se nuk do të përsëris vepra penale dhe asnjë veprim tjetër që bie ndesh me ligjin, moshën e tij të re dhe se E. i vie turp për këto veprime të cilat nuk janë veprime të cilat korrespondojnë në personalitetin e tij sepse E. është një djalë i sjellshëm dhe gëzon një reputacion të shkëlqyer në rrethin ku jeton dhe punon. Gjithashtu kërkojmë nga ju që me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të zbatoni dispozitën nga neni 70. 71 dhe 72 e që në rastin konkret për të mbrojturin tim të shqiptoni një dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 72 të KPPRK-së me të cilin konsiderojmë se do të arrihet qëllimi i paraparë me ligj të dënimit ose mbrojtja kërkon që me pëlqimin e të pandehurit dënimin e shqiptuar ta shndërroni me dënim me gjobë.

Mbrojtësi i të pandehurit të tretë deklaroi se, unë si mbrojtës i mbështes në tërësi deklaratime e kolegëve të mi të cilët paraprakisht u deklaruan andaj dhe për të mos i përsëritur ato që ata i than e që vlejné edhe për të mbrojturin tim mbetem në tërësi pranë atyre që ata kanë deklaruar.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatët mbrojtës të tyre, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Raporti i oficerit i dt. 22.05.2024, Raporti i oficerit i dt. 22.05.2024, Raportet mjekësore të lëshuar nga QKMF-Ferizaj të dt.13.10.2024, Ekspertiza mjeko-ligjore e dt.28.10.2024, Vërtetimi mbi sekuestrimin e armës i datës 12.10.2024, Deklarata e të dëmtuarit A.L.1 të dhënë në prokurori me datë 16.10.2024, Deklarata e të dëmtuarit A.L. të dhënë në prokurori me datë 16.10.2024, Deklarata e dëshmitares Sh. L. të dhënë në polici me datë 13.10.2024, Deklarata e të pandehurit E.M. të dhënë në prokurori me datë 23.10.2024, Deklarata e të pandehurit A.F. të dhënë në prokurori me datë 22.10.2024, Deklarata e të pandehurit E.F. të dhënë në prokurori me datë 22.10.2024 si dhe video-incizimet nga vendi i ngjarjes dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242 paragrafi 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *(nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të tre të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të bashkëkryerjes Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 nen par. 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin e parë edhe të veprave penale Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitive të këtij aktgjykimi, në të cilat janë përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprave penale, për çka dhe të pandehurit u shpallën fajtor dhe ju shqiptuan dënime siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se të gjithë të pandehurit e kanë bërë pranimin e fajësinë, duke e shprehur pendimin dhe keqardhjen e tyre për veprat penale të kryera, premtimet e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin kesi lloj vepre penale, se nuk ka ndonjë dëshmi për asnjërin prej të akuzuarve se më parë të jenë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që kjo u vërtetua nga Ekstraktet mbi dënimet penale për secilin të pandehur të nxjerrura nga Departamenti i Evidencës Qendrore Penale të KGJK-së, ndërsa rrethana renduese nuk u gjetën por gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale. Andaj bazuar në rrethanat e sipërpërmendure në kuptim të neneve 71 par. 1 nën par 1.3 dhe nenit 72 par. 1 nën par 1.5 të KPRK-së, gjykata të pandehurve u bëri zbutjen e dënimit dhe ju shqiptoj dënim nën minimumin e paraparë ligjor, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimet e shqiptuar janë plotësisht të justifikueshme, në përshtatje me rrethana të kryerjes, rrezikshmërisë dhe autorëve të tyre, që do të shërbej në parandalimin e

kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale (preventiva gjenerale)

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesave pasurore-juridike, është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle dhe të procedures, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par. 2 nën par.2.6 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL

2024:317190, datë 18.11.2024

Zyrtare ligjore

Gjyqtari i vetëm gjykues

Kimete Bytyqi

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.